

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Supreme e Kosovës – kolegji i përbërë nga gjyqtarët Emine Mustafa kryetare, Valdete Daka dhe Nesrin Lushta, anëtare, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të dënuarit B.Sh., nga Ferizaj, për shkak të veprës penale ushtrimi i ndikimit nga neni 431 par.1 të KPK, due vendosur sipas kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë paraqitur nga mbrojtësi i të dënuarit, avokat Avni Ibrahim, nga Ferizaj, ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore Ferizaj – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.106/2016 datë 17.1.2017 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PAKR.nr.128/2017 datë 28.4.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur më 14 maj 2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të të dënuarit B.Sh., ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore Ferizaj – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.106/2016 datë 17.1.2017 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PAKR.nr.128/2017 datë 28.4.2017.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore Ferizaj – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.106/2016 datë 17.1.2017, i dënuari B.Sh., është shpallur fajtor për shkak të veprës penale ushtrimi i ndikimit nga neni 431 par.1 të KPK dhe është gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 4 (katër) muajve, në të cilin dënim i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 24.3.2014 deri më 23.4.2014. I dënuari është obliguar që të paguajë shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë së gjykatës ndërsa në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 50 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Në procedurën ankimore Gjykata e Apelit të Kosovës, me aktgjykimin PAKR.nr.128/2017 datë 28.4.2017, ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtësit të të dënuarit ndërsa aktgjykimi i shkallës së parë është vërtetuar.

Kundër këtyre aktgjykimeve kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka ushtruar mbrojtësi i të dënuarit, av. Avni Ibrahim, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave

të procedurës penale nga neni 384 par.1 nënpar.1.12 të KPPK-së dhe shkeljes së ligjit penal nga neni 385 par.1 nënpar.1.1 të KPK, me propozim që aktgjykimet e kundërshtuara të anulohen dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.

Prokurori i Shtetit, me shkresën KMLP.II.nr.179/2017 e datës 27.9.2017, ka propozuar që të refuzohet si e pabazë kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë.

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit, pasi shqyrtoi të gjitha shkresat e çështjes e në kuptim të dispozitës së nenit 435 par.1 dhe 436 par.1 të KPPK, vlerësoi pretendimet nga kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë dhe konstatoi:

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e ushtruar nga mbrojtësi i të dënuarit B.Sh., është e pabazuar.

Mbrojtësi i të dënuarit në kërkesë pretendon se aktgjykimet janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të cilat konsistojnë në faktin se dispozitivi i aktgjyimit është në kundërshtim me arsyetimin dhe atë nga fakti se nga përshkrimi nuk rezulton se si dhe për çka do të ushtron ndikim i dënuari B.Sh., te personi zyrtar – polici N.G. dhe për cilin vendim është fjala kur dihet se polici hetues nuk është zyrtar që shqyrton, vlerëson dhe merr vendime në çështjet penale dhe në procedurën penale. Madje dispozitivi përmban edhe kundërthënie me vetveten, kur prezantohet se i dënuari ka kërkuar dhuratë ... duke i premtuar se do t'i ndihmon, edhe pse ndikimi në personin zyrtar nuk është realizuar. Më tutje në kërkesë mbrojtësi pretendon se aktgjykimet nuk përmbajnë arsye për faktet vendimtare ndërsa arsyet e prezantuara janë kundërthënëse dhe të paqarta. Kjo më së shumti vërehet në faktin se aktgjykimi i shkallës së parë mbështetet ekskluzivisht në deklaratat e dhëna në polici më datë 25.2.2014 nga dëshmitarët B.Sh. dhe L.M. të cilat nga ana e mbrojtësit nuk kanë mundur të kundërshtohen në asnjë fazë të procedurës përmes marrjes së tyre në pyetje. Sa i përket shkeljes së ligjit penal mbrojtja konsideron se gjykata e shkallës së parë duke e bazuar aktgjykimin e saj me vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike shkel ligjin penal në dëm të dënuarit B.Sh. kur e shpall fajtor për veprën penale për të cilën është gjykuar edhe pse në veprimet e tij nuk ekzistojnë elementet e veprës penale e cila i vihet në barrë.

Gjykata Supreme duke vlerësuar pretendimet nga kërkesa si dhe nga shkresat e çështjes konstatoi se qëndron fakti se dëshmitarët B.Sh. dhe L.M. kanë dhënë një deklaratë në polici më datë 25.2.2014, por dëshmitari B.Sh. në shqyrtimin gjyqësor të datës 2.11.2016 në procesverbal po të njëjtës datë është dëgjuar si dëshmitar dhe me atë rast pasi që ka qenë i udhëzuar konform të dispozitave të nenit 125 par. 1 të KPK, është deklaruar, dhe në atë seancë prezent ka qenë edhe mbrojtësi i të dënuarit avokati Avni Ibrahimimi dhe ka pasur mundësi që t'i bëjë pyetje të drejtpërdrejta. Në deklaratë, dëshmitari në detaje ka përshkruar tërë ngjarjen duke treguar se i dënuari B.Sh. ka qenë polic patrulle në stacionin policor në Ferizaj dhe se me të njëjtin është takuar së bashku edhe me dëshmitarin L.M. ku takimi i parë ka ndodhur te banesa e të dënuarit

ku është biseduar për mundësinë e ndihmës së të dënuarit lidhur me lëndën e vjedhjes ku të dyshuar kanë qenë të dy dëshmitarët dhe E.H., dhe se për këtë i ka kërkuar para 200 apo 250 €, ndërsa takimi i dytë ka qenë te rrethi në Rr. E “Varoshit” dhe “Ahmet Kaçiku” ku përsëri është biseduar për para dhe meqë dëshmitari nuk kishte para, ka ofruar një pushkë automatike të cilën i dënuari nuk e ka pranuar por iu ka sugjeruar që këtë pushkë ta shesin dhe paratë t’ia sillnin atij. Dëshmitari L., ka pranuar ta shes dhe kjo edhe ka ndodh ashtu që pushka i është shitur një personi në Viti ndërsa paratë i ka marrë L.M. dhe atë shumën prej 150 € të cilat sipas fjalëve të tij ia ka dhënë të dënuarit edhe pse dëshmitari Betim nuk ka qenë prezent kur paratë janë dhënë të dënuarit. Të gjitha këto janë bërë me qëllim që i dënuari të ndikoj tek polici N.G., i cili ka qenë polici hetues në rastin e vjedhjes ku të dyshuar kanë qenë dëshmitarët B.Sh. dhe L.M. Gjatë dhënies së deklaratës në polici lidhur me veprën penale të vjedhjes në zyrë ka qenë prezent polici N.G. dhe deri sa është marrë në pyetje B., në zyrë ka hy i dënuari B.Sh. dhe ka kërkuar që polici N., të larohet nga zyra. I dënuari i ka sugjeruar dëshmitarit që ta pranon veprën se ai do t’i rregullon gjërat dhe kështu ka ndodhur, dëshmitari ka pranuar veprën penale për të cilën është ngarkuar kur është kthyer polici N.G. në zyrë dhe pas intervistës kanë dal dhe janë takuar me të dënuarin së bashku edhe me L.M. Për të gjitha këto dëshmitari ka njoftuar edhe IPK (Inspektoratin Policor të Kosovës) dhe pastaj ka filluar të zhvillohet procedura ndaj të dënuarit.

Të gjitha këto bëjnë që pretendimi se aktgjykimi bazohet vetëm në deklaratat e dhënë në polici nuk qëndron sepse siç u cek më lartë dëshmitari B.Sh. është dëgjuar në cilësinë e dëshmitarit në shqyrtim gjyqësor e po ashtu edhe dëshmitari L.M., i cili është dëgjuar në shqyrtim gjyqësor, edhe pse mohon që i dënuari ka kërkuar para nga i njëjti megjithatë, nuk e mohon se janë takuar disa herë me policin-të dënuarin B.Sh. dhe se nga i njëjti kanë kërkuar ndihmë. Aktgjykimi i shkallës së parë, pra, nuk është bazuar në deklaratat e dhëna në polici të dëshmitarëve dhe pse ato janë lexuar dhe janë administruar si prova por në aktgjykim janë dhënë arsyetimet se pse i është dhënë besimi këtyre deklaratave, duke bërë vlerësimin e të gjitha provave veç e veç dhe të ndërlidhura njëra me tjetrën ndërkaq në shkresa të çështjes dhe në aktgjykim potencohen të gjitha provat në bazë të cilave është vërtetuar përgjegjësia penale e të dënuarit. Kështu, në aktgjykim potencohet se i njëjti bazohet në prova dhe atë në deklaratën e dëshmitarit N.G., B.Sh., në deklaratën e lexuar të dëshmitarit L.M., kallëzimin penal që ka të bëjë me të pandehurin A.Z., për veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll, posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 i KPK, (personi tek i cili është shitur pushka automatike nga dëshmitari L.M.), pra aktgjykimi mbështetet në një mori provash të cilat janë administruar në shqyrtim gjyqësor.

Sa i përket pretendimit se në dispozitiv nuk përshkruhen veprimet e të dënuarit me të cilat është dashur që të ushtroj ndikim në vendimmarrjen e personit zyrtar konkretisht policit hetues N.G., kjo gjykatë gjen se në dispozitiv përshkruhen qartë veprimet e të dënuarit dhe atë kur thuhet “me qëllim që të ushtroj ndikim të padrejtë në vendimmarrjen e personit zyrtar, polici hetues N.G., që të ndihmojë të dyshuarit, të mos ushtrohet kallëzimi penal ose të ndihmohet pas ushtrimit të kallëzimit penal ...”.

Qëndron fakti se ndikimi në personin zyrtar nuk është realizuar sepse ndaj të dyshuarve është iniciuar procedura por konform dispozitës së nënti 431 par.1 të KPK, vepra penale e ushtrimit të ndikimit konsumohet pavarësisht nëse ndikimi është ushtruar ose pavarësisht se ndikimi i supozuar shpie deri te rezultati i synuar, andaj nuk qëndron as pretendimi se deri tek konsumimi i veprës penale nuk ka ardhur meqë ndikimi i ushtrimit nuk është arritur.

Meqë kjo Gjykatë gjen se ndaj të dënuarit nuk është shkelur ligji penal në dëm të të njëjtit kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë u konsiderua si e pabazë dhe u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e konform nenit 437 të KPPK.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË
Pml.nr. 257/2017, më 14 maj 2018

Procesmbajtësi,
Bujar Balaj

Kryetare e kolegjit,
Emine Mustafa